

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHITES
OPŠTINA STIMLJE - MUNICIPALITY OF SHITIME

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, (pika c) dhe nenit 34, paragrafi 34.4, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), Nenit 10,11 dhe 12, të Statutit të Komunës së Shtimes, 01 Nr.06/1636, datë 03.09.2008, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Komisioni i propozon Kuvendit për miratim këtë:

DRAFT

**RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E
KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË
KOMUNËN E SHITES**

Neni 1
Qëllimi

Rregullorja ka për qëllim organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Shtimes, në themelimin e Këshillave Lokale, ushtrimin e disa aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës.

Neni 2
Fushëveprimi

Rregullorja përcakton themelimin, formën dhe mënyrën e bashkëpunimit të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Shtimes, duke formuar Këshilla Lokale, si trupa mbështetës të komunës që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse për çështjet me interes publik, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Neni 3
Formimi i Këshillave Lokale

Për të realizuar sa më mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Komuna e Shtimes, do të mbështesë zgjedhjen e Këshillave Lokale të fshatrave,

vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e Këshillave Lokale. Një Këshill Lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Numri i Këshillave Lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivele të Këshillave Lokale dhe janë parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Komisioni për përzgjedhjen e Këshillave Lokale

1. Kuvendi i Komunës themelon një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë. Përbërja duhet të jetë: katër (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës (nga subjekte të ndryshme politike), një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane. Përfaqësuesi nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit Lokal, zgjedhet në mënyrë ad-hoc nga Komisioni.
2. Komisioni duhet të reflektojë përfaqësim gjinor. Nga pesë (5) anëtarët e komisionit, përfaqësimi gjinor do të jetë dy (2) të gjinisë femërore, tre (3) të gjinisë mashkullore.
3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e Komisionit.
4. Mandati i komisionit është lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.
5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtarë dhe kryetarë të Këshillave Lokale.
6. Së paku pesë (5) anëtarë të komisionit, prej të cilëve së paku dy (2) përfaqësues nga Kuvendi i komunës, duhet të jenë të pranishëm në të gjitha takimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e Këshillave Lokale.
7. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të Këshillave Lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
8. Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës për procesin e përzgjedhjes së Këshillave Lokale.

Neni 5

Këshillat Lokale në Komunën e Shtimes

1. Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2019, neni 4, paragrafi 2, pika 2.3, në territorin e Komunës së Shtimes, mund të themelohen deri 12 Këshilla Lokale-zona si më poshtë:

- 1.1 Zona 1: Shtime
- 1.2 Zona 2: Shtime
- 1.3 Zona 3: Petrovë, Mollopolc, Llanisht, Devetak, Topillë
- 1.4 Zona 4: Godanc i eperm, Godanc i Poshtëm, Lagjja e Pajtimt
- 1.5 Zona 5: Pjetershticë, Dugë, Karaqicë
- 1.6 Zona 6: Belinc, Carralevë, Rancë, Zborc
- 1.7 Zona 7: Reçak
- 1.8 Zona 8: Davidovc, Rashincë, Gllavicë
- 1.9 Zona 9: Muzeqinë, Vojnoc, Gjyrkovc

Neni 6

Njoftimi për organizimin e takimeve për përzgjedhjen e Këshillave Lokale

1. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, përmes zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë për zgjedhjen e Këshillave Lokale, përmes:
 - 1.1. Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe hapësirat më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen takimet për zgjedhjen e Këshillave Lokale;
 - 1.2. Mediave lokale;
 - 1.3. Ueb-faqes zyrtare të Komunës;
 - 1.4. Platforma tjera të komunikimit;
2. Njoftimi për publikun duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit.

Neni 7

Përbërja e Këshillave Lokale

1. Këshilli Lokal mund të ketë pesë (5) deri në nëntë (9) anëtarë. Numri i anëtarëve për secilin Këshill Lokal, përcaktohet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në takimin zgjedhor.
2. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në Këshillin Lokal duke përfshirë edhe përfaqësimin gjinor. Në rastet ku ka komunitete joshumicë, edhe përfaqësimi etnik.
3. Fshati me numër më të madh të banorëve përfaqësohet me një anëtar më shumë se fshatrat tjerë të Këshillit Lokal – zonës.
4. Anëtarë të Këshillave Lokale zgjedhen me votim të fshehtë ose të hapur.
5. Zgjedhen anëtarë kandidatët e propozuar të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve me të drejte vote të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, që janë të pranishëm në takimin zgjedhor.
6. Kryetari i Këshillit Lokal zgjedhet kandidati i cili fiton numrin më të madh të votave të qytetarëve që marrin pjesë në takim.
7. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo me shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë mbahet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar dhe kryetar të këshillit lokal.
8. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe të kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publike në ueb faqen zyrtare të komunës dhe platformave tjera të komunikimit menjëherë pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të ankesave.
9. Procesverbali i hartuar nga tubimet me qytetarë për formimin e këshillave lokale, duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në takim, listën e pjesëmarrësve, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.
10. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi i komisionit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi.

Neni 8

Kriteret e përzgjedhjes për Këshillat Lokale

1. Kandidatët për anëtarë të Këshillave Lokale duhet të jenë banorë të atij lokaliteti, së paku në 5 vitet e fundit.
2. Verifikimi i anëtareve bëhet me dokument të identifikimit të Republikës së Kosovës (Letërnjoftim, Patentë shofer apo Pasaportë) e të njëjtit evidentohen dhe nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes në votim.
3. Kandidatët për anëtarë dhe kryetarë të Këshillave Lokale nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur apo të emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike, zyrtarë në pozicione udhëheqëse në institucionet komunale, antarët e Kuvendit.
4. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të propozojë së paku dy kandidatë për përfaqësim në Këshillin Lokal.
5. Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë pjesëmarrës më të drejtë vote të asaj zone, duke respektuar kuotën gjinore dhe përfaqësimin etnik në lokalitete ku ka banorë të komunitetit jo shumicë.
6. Përbërja e Këshillave Lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore sipas legjislacionit në fuqi.
7. Në Këshillin Lokal përfaqësohet edhe komuniteti jo shumicë me numër më të madh të banorëve të atij lokaliteti që janë të pranishëm në takim dhe votojnë.
8. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në takimin me qytetarë.

Neni 9

Komisioni i Ankesave

1. Kuvendi i Komunës themelon Komisionin e Ankesave i cili shqyrton ankesat lidhur me procesin e zgjedhjes të Këshillave Lokale.
2. Komisioni i Ankesave do të ketë 3 anëtarë nga subjekte politike të ndryshme të cilët zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Shtimes. Anëtarët e Komisionit të Ankesave nuk mund të jenë të njëjtë me anëtarët e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale.
3. Të gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor.
4. Ankesat për parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten pranë Komisionit për Ankesa brenda 3 ditëve të punës.
5. Komisioni i Ankesave është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimt të kërkesës, t'u kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën. Vendimet e Komisionit të Ankesave i përcillen Kryesuesit të Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale menjëherë pas marrjes së tyre.
6. Vendimet e Komisionit të Ankesave janë obligative.
7. Komisioni i Ankesave i raporton Kuvendit të Komunës.

Neni 10

Mandati i Këshillave Lokale

1. Mandati i Këshillave Lokale është katër (4) vite.
2. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Këshillave Lokale përfundon si në vijim:
 - 2.1. me kryerjen e mandatit;

- 2.2. nëse jep dorëheqje;
 - 2.3. nëse shkarkohet;
 - 2.4. nëse ndërron vendbanimin;
 - 2.5. në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër;
 - 2.6. nëse vdes.
3. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillave Lokale bëhet sipas procedurës së zgjedhjes.
 - 3.1 Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe/ose anëtarëve të Këshillave Lokale inicohet nga banorët e zonës të Komisioni për Zgjedhjen e Këshillave Lokale. Inicimi i procedurës së shkarkimit të kryetarit dhe/ose anëtarëve të Këshillave Lokale bëhet me petition dhe duke përfshirë 51% të pjesëmarrësve të përzgjedhur në Këshill, si dhe dëshmi që kryetari dhe/ose anëtarët e Këshillave Lokale kanë shkelur detyrat dhe përgjegjësitë e rregulluara me nenin 12 të kësaj rregulloreje.
 4. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të Këshillit Lokal, komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të organizojë zgjedhjet për kryetar të ri.
 5. Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillave Lokale në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes, me aprovimin e komisionit të kuvendit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Neni 11

Konsultimet ndërmjet Komunës dhe Këshillave Lokale

1. Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit, organizojnë së paku dy takime në vit me kryetarët e Këshillave Lokale.
2. Kryetarët e Këshillave Lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate publike dhe konsultime publike me qytetarë.
3. Kuvendi i Komunës duhet të konsultojë Këshillin Lokal, në çështje të caktuara publike dhe me interes për komunitetin.

Neni 12

Përgjegjësitë dhe detyrat e Këshillit Lokal

1. Këshilli Lokal përfaqëson çështjet me interes të përgjithshëm të komunitetit.
2. Miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
3. Në mënyrë që kërkesat e qytetarëve të përcjellën rregullisht tek organet kompetente në komunë, Këshilli Lokal obligohet që të organizojë takime me qytetarë. Numri i takimeve të Këshillit Lokal sqarohet më tej në nenin 16, paragrafin 5 të kësaj rregulloreje.
4. Këshilli Lokal organizon, përcjellë dhe ndihmon në hartimin e planeve dhe programeve zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, komitetet dhe drejtoritë komunale.
5. Këshilli Lokal duhet të informojë komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarë kompetent komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
6. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal.
7. Këshilli Lokal mund të ndërmarrë aktivitetet, të cilat në veçanti ndikojnë në:
 - 7.1 Planifikimin urban dhe rural;
 - 7.2 Furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimin;

- 7.3 Rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda këshillit lokal;
 - 7.4 Shëndetësinë publike;
 - 7.5 Mbrojtjen lokale të ambientit;
 - 7.6 Turizmin;
 - 7.7 Hapësirave publike dhe varrezave;
 - 7.8 Aktiviteteve kulturore dhe sportive etj.
 - 7.9 Aktivitetet vullnetare në interes për këshillin lokal;
 - 7.10 Mirëqenien e banorëve të këshillit lokal – sigurimi i të dhënave për çdo familje, duke përcjellë gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime për mbështetje të këtyre rasteve.
 - 7.11 Bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizatat tjera të shoqërisë civile – organizata joqeveritare, shoqata, klube etj., për çështje me interes për lokalitetin.
 - 7.12 Zbatimin e aktiviteteve që janë bartur, sipas procedurave të nenit 11 të kësaj rregulloreje.
8. Me pëlqimin e Kryetarit të Komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve për monitorimin, zbatimin e projekteve për investime kapitale në lokalitetet e tyre.
 9. Këshillat lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës të Shtimes.
 10. Këshillat lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë me këshillat lokale nga komunat tjera për projekte që prekin interesin e banorëve të atyre zonave.
 11. Këshillat lokale kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë me shkrim, qoftë fizikisht ose përmes postës elektronike zyrtare, zyrës së Kryetarit të Komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit dhe komuna i përgjigjet brenda afatit prej 30 ditësh.
 12. Marrëveshjet të cilat i lidhë Komuna me Këshillat Lokale duhet të miratohen nga Drejtoria përkatëse në Komunë.

Neni 13 **Marrëveshja e bashkëpunimi**

1. Marrëveshja e bashkëpunimit të Komunës me Këshillat Lokale duhet të përmbajë së paku këto elemente:
 - 1.1 Objektin e marrëveshjes;
 - 1.2 Kohëzgjatjen;
 - 1.3 Përshkrimin e obligimeve për palët;
 - 1.4 Dinamikën e realizimit të punëve;
 - 1.5 Koston financiare.
2. Objekti i marrëveshjes nuk mund të jenë përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës, të përcaktuara në nenin 40.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 14 **Roli i kryetarëve të Këshillave Lokale**

1. Kryetari i Këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e Komunës.

2. Kryetari i këshillit Lokal ka obligim t'i informojë anëtarët e këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet me organet e komunës.
3. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjen e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit.
4. Kryetari i Këshillit Lokal nënshkruan konkluzionet dhe propozimet e miratuara nga ana e Këshillit Lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre t'i adresojë në Zyrën e Kryetarit të Komunës.
5. Kryetari i Këshillit Lokal mbanë sëpaku 6 takime me Këshillin Lokal të Zonës.

Neni 15

Financimi i aktiviteteve

1. Aktivitetet e Këshillave Lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale mund të financohen si vijon:
 - 1.1 Nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
 - 1.2 Nga komuna;
 - 1.3 Nga donatorët; dhe
 - 1.4 Me financim të përbashkët.

Neni 16

Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale

1. Për punën e tyre kryetarët e Këshillave Lokale kompensohen nga buxheti i komunës së Shtimes.
2. Kompensimi për kryetarët e Këshillave Lokale bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të Këshillit Lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.
4. Kompensimi bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit sipas nenit 14, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
5. Numri i mbledhjeve me kompensim është gjashtë (6), ndërsa pa kompensim mund të mbahen edhe me shumë.
6. Kryetarët e Këshillave do të përfshihen në listat e telefonisë mobile, pa pagesë, brenda komunitetit ndër institucional.

Neni 17

Bartja e aktiviteteve nga Komuna te Këshillat Kokale

1. Me kërkesë të Këshillit Lokal dhe rekomandim të Kryetarit të Komunës, apo ndonjë komiteti të Kuvendit, Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar Këshillat Lokale. Aktivitetet që mund të transferohen, duhet të jenë kompetencë ekskluzive, vetanake të komunës.
2. Këshilli Lokal duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga Komuna.
3. Bartja e aktiviteteve nga Komuna në Këshillin Lokal duhet të mbështetet me financim dhe burime tjera të nevojshme për realizimin e aktiviteteve sipas përgjegjësi të bartura.

Neni 18
Mospërmbyshja e përgjegjësi

Këshilli Lokal mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga organet e Komunës në Këshillin Lokal.

Neni 19
Dispozitat kalimtare

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregullore me Ligjin për Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane apo me Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit, Udhëzimit Administrativ apo Statutit.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale të Komunës së Shtimes, të datës: 27.3.2015.


Neni 20
Përgjegjësia për zbatim

1. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.
3. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe 7 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ueb-faqen e Komunës.

Kryesuesi i Komisionit



Valon Januzi